VENDIM
Nr. 15, datë 23.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERA HYDRO" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "STRORI", ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "a"; të nenit 5, pika 1, germa "a"; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 19/2 prot., datë 18.1.2020 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Era Hydro" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Strori", me kapacitet të instaluar 2000 kw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Era Hydro" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 17 prot., datë 7.1.2020, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Strori".

- Shoqëria "Era Hydro" sh.p.k. është njohur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si mbajtëse e miratimit dhe ka nënshkruar me të kontratën nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "Strori", me kapacitet prodhues 2 mw, në përroin e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan". Kjo kontratë është lidhur midis mbajtësit të miratimit, shoqërisë "Era Hydro" sh.p.k. dhe MIE-s, me një afat 49-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Sipas programit të punimeve të kësaj kontrate, koncesionari merr përsipër:

- të fillojë punimet në zbatim të projektit, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me lejen e fillimit të punimeve të ndërtimit;

- të vërë në punë hidrocentralin, brenda 21 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç parashikohet në aneksin 2, bashkëlidhur kësaj kontrate, grafiku i zbatimit të punimeve.

- Në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", dokumentacioni i depozituar nga shoqëria "Era Hydro" sh.p.k., në aplikimin për pajisjen me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, rezulton si më poshtë vijon:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka përcjellë asnjë informacion në lidhje me të dhënat për aplikuesin (9.1/c);

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "g") është plotësuar pjesërisht;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar pjesërisht;

- dokumentacioni teknik për HEC-et (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3, germat "a", "b", "c" dhe "d", pika 4.1.4, germat "a", "b", "c" , "d", "e", pika 4.1.5, germat "a", "b", "c") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria në këtë aplikim është kryesisht i plotësuar, me përjashtim të dokumentacionit si më poshtë, i cili rezulton i munguar ose jo në formën e kërkuar nga rregullorja:

- neni 9, pika 1, germa "c" (Të dhëna për aplikuesin) nuk është sjellë në formën e kërkuar nga rregullorja.

- neni 9, pika 2, germa "c" (Vërtetimi i regjistrimit nga QKB-ja) nuk është sjellë në formën e kërkuar nga rregullorja;

- neni 9, pika 2, germa "d" (Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria): plotësuar pjesërisht. Mungojnë vërtetimet e prokurorisë dhe, duke qenë se adresa e shoqërisë rezulton të jetë në qarkun e Elbasanit, do t'i kërkohet të përcjellë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë nga ky rreth gjyqësor, si për vetë shoqërinë dhe për përfaqësuesit e saj;

- neni 9, pika 2, germa "e" (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca): e paplotësuar;

- neni 9, pika 3, germa "b" (Paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit): plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 3, germa "d" (Vërtetimin e pagesës së aplikimit në llogari të ERE-s): plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.1.1 (Të dhëna specifike për HEC-et) janë plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.1.2 (Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin): plotësuar pjesërisht;

- germa "c" (Leje mjedisore): plotësuar.

Shoqëria ka depozituar në ERE, me shkresën nr. 940 prot., datë 18.4.2017, të Ministrisë së Mjedisit, VNM-në paraprake me nr. vendimi 16 dhe nr. identifikimi 258, të lëshuar për "Era Hydro" sh.p.k., për ndërtimin dhe operimin e "Hec Strori", me kapacitet të instaluar 1972 kw. Sa i përket vlefshmërisë së kësaj lejeje, në përmbajtjen e saj citohet se: "Ky vendim është i vlefshëm pasi veprimtaria licencohet nga institucionet përkatëse. Mosfillimi i aktivitetit, brenda një periudhe dyvjeçare, sjell për pasojë pavlefshmërinë e vendimit për ushtrimin e këtij aktiviteti.".

Për dokumentacionin e munguar apo të sjellë jo në formën e kërkuar nga rregullorja do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë ato në ERE, brenda afateve të përcaktuara në nenet 10 dhe 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Era Hydro" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Strori", me kapacitet të instaluar 2000 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti